



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRII

Numri i lëndës: 2023:078088

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05754061

P.nr.117/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRII, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi me pjesëmarrjen e praktikantes Diana Fejza në çështjen penale kundër të pandehurit M.M, nga Vushtrria, për shkak te veprës penale *Vjedhja e shërbimeve* nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.244/23 të datës 19.03.2023, jashtë seancës, në mbështetje të nenit 248, par. 1, nën par. 1.4, të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit për ndërmjetësim, me datë 30.05.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET Marrëveshja e Ndërmjetësimit Nr. Ref. ND.114/2024 e datës 28.05.2024 e arritur ndërmjet të pandehurit M.M dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar KEDS.

II.HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.244/23 e datës 19.03.2023.

III.PUSHOHET procedura penale për të pandehurin M.M, i lindur me datë ... me vendbanim në rr.”...” Vushtrri, me numër personal ..., shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale *Vjedhja e Shërbimeve* nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.764/23 të datës 24.06.2023, e ka akuzuar të pandehurin M.M, nga Vushtrri, rr.”...” për shkak te veprës penale *Vjedhja e shërbimeve* nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 28.05.2024 ka caktuar shqyrtimin fillestar, në të cilën përfaqësuesi i palës së dëmtuar KEDS V.L është pajtuar që lënda të referohet në procedurë të ndërmjetësimit, e po ashtu edhe prokurori i shtetit. Gjykata sipas propozimit të tij ka dërguar këtë lëndë penale në ndërmjetësim pasi që me nenin 2, paragrafi 2, të Ligjit për ndërmjetësim është përcaktuar se ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet në rastet ku parashihet dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim deri në tri (3) vjet, përveç rasteve të parapara në paragrafin 3 të këtij neni, e që në rastin konkret vepra penale për të cilën është akuzuar i pandehuri është përcaktuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në 3 (tri) vite, kurse me nenin 8, paragrafi 7, të Ligjit për ndërmjetësim është përcaktuar se pranohet marrëveshja në mes palëve për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, në çdo fazë të zhvillimit të procedurës në gjykatë kompetente, apo në një organ tjetër kompetent.

Gjykata është njoftuar nga ndërmjetësuesi se palët, me datë 28.05.2024, kanë arritur pajtimin në ndërmjetësim ashtu që janë që çështja të zgjidhet përmes ndërmjetësimit, të cilën marrëveshje e kanë nënshkruar dhe e njëjta nga ndërmjetësuesi është proceduar në gjykatë për aprovim të marrëveshjes.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim, konstatoj se palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet me ndërmjetësim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësimit, andaj edhe gjykata të njëjtën e aprovoi si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

Gjykata duke pasur parasysh marrëveshjen e arritur në ndërmjetësimit në mes të pandehurit dhe palës së dëmtuar, e bazuar në neni 357 par. 1, pika 1.3 ka vendosur si në dispozitiv të pikës 2 dhe 3 të këtij aktvendimi.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale ka vendosur në bazë të nenit 453 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.117/2023, datë 30.05.2024

Praktikantja
Diana Fejza

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk lejohet ankesa (neni 229 par. 6 të KPP-së).